

URDHËR
Nr. 279, datë 25.4.2020

PËR LEHTËSIMIN E POSATÇËM TË LËVIZJES NË “ZONAT E GJELBËRTA”

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të pikës 4, të nenit 7, të ligjit nr. 15/2016, “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19, vendimit të Komitetit Teknik nr. 1892/1, datë 24.4.2020,

URDHËROJ:

1. Caktimin e qarkut Dibër, qarkut Gjirokastrë, zonës së përbashkët të bashkive Sarandë, Konispol, Himarë, Delvinë dhe Finiq, zonës së përbashkët të bashkive Përrenjas, Pogradec dhe Librazhd dhe Bashkia Divjakë si “zona të gjelbërta”, apo zona me rrezik të ulët të transmetimit të infeksionit nga COVID-19.

2. Në zonat e gjelbërta, pensionistët do të lëvizin lirisht në këmbë nga ora 06:00 deri në orën 08:30 dhe gjatë kësaj kohe nuk do të lejohet lëvizja e asnjë këmbësori tjetër, përveç atyre që kanë autorizim për punë.

3. Nga ora 09:30 deri në orën 17:30 lejohet të lëvizin, me jo më shumë se me një person në krah, të gjithë këmbësorët e tjerë. Përtej këtij orari lejohen të lëvizin vetë, këmbësorët që kanë autorizim pune, të cilët lëvizin sipas orarit të diktuar nga natyra e punës.

4. Ndalohet lëvizja dhe qëndrimi në një vend i më shumë se dy personave. Parqet publike dhe hapësirat e gjelbërta të rrethuara do të vazhdojnë të jenë të mbyllura edhe në këto zona për 14 ditë.

5. Mjetet e transportit të punonjësve në institucionet publike dhe/ose private do të lejohen të lëvizin me autorizimin përkatës, sipas orarit të diktuar nga natyra e punës vetëm me një pasagjer i cili duhet të ulet në pjesën e pasme të automjetit, i pozicionuar diagonal me drejtuesin e mjetit, sipas protokolleve të miratuara.

6. Lejohet lëvizja e mjeteve private, pa autorizim, vetëm brenda qarkut ose bashkive përkatëse nga ora 09:30 deri 17:30, vetëm me një pasagjer në automjet, i cili duhet të ulet në pjesën e pasme të automjetit, i pozicionuar diagonal me drejtuesin e mjetit, sipas protokolleve të miratuara.

7. Ndalohet lëvizja e pensionisteve me mjete private ose marrja e tyre si pasagjerë me përjashtim të rasteve kur kanë një autorizim për të lëvizur ose emergjencave shëndetësore.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu